



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1101/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër Arvanita Haxhija, nga Gjakova, rruga “Faik Konica”, Gjakovë, për shkak të fotografimit të votës, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.1101/2017 e datës 20.11.2017, paraqitur kundër Arvanita Haxhija, nga Gjakova, rruga “Faik Konica”, Gjakovë, për shkak të fotografimit të votës, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 19.11.2017.

### A r s y e t i m

Me datën 20.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me të cilën ka pretenduar se Arvanita Haxhija, ka bërë shkelje ligjore duke publikuar votën e saj në rrjetet sociale, pikrisht në profilin e saj në (snapchat).

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, ka theksuar se, publikimi i votës në rrjetet sociale është përgjegjësi penale e personave që kanë bërë këtë shkelje dhe i takon prokurorisë së shtetit të merret me çështjen në fjalë. Më tej ka theksuar se AAK ka vepruar në baz të Ligjit Nr.11/2013 neni 3.3, 3.4 dhe 3.6 për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta respektojnë ligjin në fuqi dhe rregulloren e kodit të mirësjelljes.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur lajmërimin publik të AAK-së për respektimin e e Kodit Zgjedhor.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se Arvanita Haxhija nga Gjakova, ka bërë shkelje ligjore duke publikuar votën e saj në profilin e saj në (snapchat), paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi pasi që nga fotografia që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë dhe të sigurt shkelja e pretenduar.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që ti vërtetoj pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL Anr.1101/2017 më datë 21.11.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*